




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr. 513/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 33 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 2 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në takimin 317-të, të mbajtur më 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet rekomandimi i Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, i datës 8 nëntor 2023, për hartimin e Udhëzuesit Administrativ për Regjistrimin e Seancave Gjyqësore.
- II. Hartimi i Udhëzuesit Administrativ për Regjistrimin e Seancave Gjyqësore, të përfshihet në Planin e Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka shqyrtuar rekomandimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës nga takimi i datës 8 nëntor 2023, për hartimin e Udhëzuesit Administrativ për Regjistrimin e Seancave Gjyqësore.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës, llogaridhënies si dhe ngritjes së besimit të qytetarëve në efikasitetin e sistemit të drejtësisë, konsiderohet i domosdoshëm hartimi i Udhëzuesit për regjistrimin e seancave gjyqësore, i cili po ashtu do t'iu shërbej të gjitha gjykatave për unifikim të praktikës gjyqësore për sa i përket publicitetit.

KGJK në takimin e 317-të, të datës 27 nëntor 2023, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryesuesit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Komisionit për Administrimin e Gjykatave;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.

